

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil**, nga Gjyqtari **Drilon HARAÇIA** me pjesëmarrjen e sekretares juridike Valbone Hoxha, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve L. K. A. K. S. K., S. K. S. K. dhe S. K. që të gjithë nga Gjakova, tani me banim në Gjermani, të cilët i përfaqëson H. P. avokat nga Gjakova, me autorizim në lëndë, kundër të paditurve F. B. Sh. B. Sh. B. S. H., e lindur B.dhe F. D. e lindur B.që të gjithë nga Gjakova, tani me adresë të panjohur, të cilëve iu është caktuar përfaqësuesi i përkohshme E. B. avokat nga Gjakova, baza juridike; për vërtetimin e pronësisë, vlera e kontestit 5.000 €, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me dt.12.12.2018, në prezencën e të autorizuarit të paditësve dhe të përfaqësuesit të përkohshëm të paditurve, me datën **11.01.2019**, mori këtë;

## A K T G J Y K I M

**I.MIRATOHET** kërkesë-padia e paditësve dhe **VËRTETOHET** se paditësit **L. K. A. K. S. K., S. K. S. K. dhe S. K. që të gjithë nga Gjakova, tani me banim në Gjermani**, si pasardhës të të ndjerit Xh. K. ish nga Gjakova, janë bashkë pronar secili me nga 1/6 të paluajtshmerisë e cila evidentohet si ngastër kadastrale nr.....Gjakovë J.Qytet, vendi i quajtur C. P. me kulturë shtëpi me sipërfaqe prej 354 m2 dhe kulturë oborr 149 m2, me sipërfaqe të përgjithshme 503 m2, e cila evidentohet sipas certifikatës të lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në Gjakovë me dt.23.08.2016, ashtu që **DETYROHEN** të paditurit **F. B. Sh. B. Sh. B. S. H., e lindur B.dhe F. D. e lindur B.që të gjithë nga Gjakova, tani me adresë të panjohur**, si pasardhës së të ndjerit H.B.ish nga Gjakova, të iu pranojë këtë drejtë dhe të lejojnë që kjo paluajtshmeri në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër në Gjakovë të regjistrohët në emër të paditësve, në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ky aktgjykim do të i shërbej si titull ekzekutiv për regjistrim.

**II.**Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

## A r s y e t i m

Paditësit nëpërmjet të autorizuarit të tyre kanë parashtruar në padi pranë kësaj gjykatë duke theksuar Paditësja e parë është bashkëshortja ndërsa paditësit prej 2 deri në 6-të janë fëmijët e të ndjerit Xh. K. ish nga Gjakova. Paraardhësi i paditësve nga paraardhësi i të paditurve, me paraardhësi i të paditurve, me dt.23.02.1988, ka blerë palujtëshmerinë e cila evidentohet si palujtëshmeri me kulturë parcelë më sipërfaqe prej 503 m2 sipas Certifikatës mbi të drejtat pronësore e lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale në Gjakovë. Lidhur me këtë shitblerje është përpiluar edhe Kontratë mbi shitblerjen e palujtshmerisë e cila është e legalizuar te Gjykata kompetente. Paraardhësi i paditësve, pas kësaj shitblerje të paluajtshmerisë lëndore, ka hyrë në posedim dhe la ndërtuar shtëpinë e banimit me një objekt përdhese dhe atë palujtëshmeri e shfrytëzon në mënyrë të lirë dhe të qetë edhe sot e kësaj dite të pa shqetësua nga askush. Paditësit kanë bërë përpjekje që të kontaktojnë me të paditurit lidhur me bartjen e palujtshmerisë në emër dhe pronësi të paditësve, por pa sukses sepse me të paditurit nuk ka qenë mundur që të kontaktohet. Përndryshe paditësi këtë paluajtshmeri e shfrytëzon edhe e posedon në mënyrë të lirë dhe të qetë pa ndërprerë me shumë se 27 vite dhe se të drejtën e pronësore në këtë paluajtshmeri e ka fituar edhe në bazë të institucionit të mbajtjes me mirëbesim. Andaj parashtroni se në rastin konkret, janë plotësuar kushtet e parapara me nenin 40 të Ligjit për Pronësi edhe të Drejtat tjera sendore. Për fitimin e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, si mënyrë origjinare e fitimit të drejtës së pronësisë. Kjo për faktin se parashkrimi i rregullt për fitimin e të drejtës së pronësisë në

sendin e paluajtshëm në bazë zë dispozitave së sipërshënuar, parasheh se posedimi duhet të jetë i ligjshëm dhe me mirëbesim, respektivisht të jetë posedues i ligjshëm dhe me mirëbesim i paluajtshmërisë mbi të cilën e fiton të drejtën e pronësisë me mbajtje me kalimin e kohës prej 10 vitesh.

I autorizuari i paditësve në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, duke theksuar se paluajtshmërinë e cilësuar si në referatin e padisë, paraardhësi i paditësve e ka blerë nga paraardhësi i të paditurve për çka është përpiluar dhe kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme e dt.23.02.1988. Nga e njëjta kontratë vërtetohet edhe se të gjitha pre stacionet që para ardhësi i paditësve i ka pasur ndaj paraardhësit të paditurve, i ka përmblusur në tërësi. Njëherit theksojmë se paditësit këtë paluajtshmëri e shfrytëzojnë dhe kanë në posedim në mënyrë të lirë dhe të qetë pandërprerë me shumë se 27 vite, çka nga kjo rezulton se në rastin konkret janë plotësuar të gjitha kushtet parapara me nenin 40 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, përfitimin e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues si mënyrë origjinare e fitimit të drejtës së pronësisë. Gjykatës i propozoi që pas administrimit të provave këtë çështje kërkesës padinë të konsideroj si të pa themeltë. Propozoi që të dilet në vend që të bëhet identifikimi dhe matja në vend nga DGJK dhe eksperti i ndërtimtarisë që të bëjë vlerësimin e pronës po ashtu edhe vjetërsinë, po ashtu i propozoi Gjykatës që të cilësinë e dëshmitarëve të dëgjohen R. T. nga fsh.B. Komuna Gjakovës dhe M. H. nga Gjakova, po ashtu Gjykatës në mënyrë të drejtë për drejtë ia dorëzoi kartelën financiare të lëshuar nga Komuna e Gjakovës, lidhur me tatimin në pronë të lëshuar me dt. 30.05.2018 si dhe transaksionin e konsumatorit të lëshuar nga K. në emër të Xh. K., paraardhësi i paditësve, të dt. 30.05.2018. në mënyrë që të vërtetohet posedimi.

I autorizuari i paditësve deklaroi se pas sqarimit të ekspertit të gjeodezisë e bëjë precizimin e kërkesë padisë si më poshtë. Vërtetohet se paditësit L. K. A. K. S. K., S. K. S. K. dhe S. K., janë bashkë pronar secili me nga 1/6 të paluajtshmërisë e cila evidentohet si njësi kadastrale nr. ..., me kulturë shtëpi në sipërfaqe prej 354 m<sup>2</sup> dhe me kulturë oborr në sipërfaqe prej 149 m<sup>2</sup>, e në sipërfaqe të përgjithshme prej 503 m<sup>2</sup>, ashtu që detyrohen të paditurit F. B. Sh. B. Sh. B. S. B. dhe F. D. e gjinisë B, që të gjithë më parë nga gjakova, e tani me adresë të panjohur, që paditësve të ju njohin këtë të drejtë dhe të lejojnë që në elaboratet e zyrës kadastrale komunale në Gjakovë, kjo paluajtshmëri të regjistrohet në emër dhe pronësi të paditësve në afatin prej 15 ditëve nën kërcënimin e përmbarimit.

I autorizuari i të paditurve në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se nga administrimi i provave u vërtetua në mënyrë bindëse se paditësit janë bashkë pronar të paluajtshmërisë e cila është objekt i padisë dhe kërkesës së saj. Besueshmëria e kësaj kërkesë u vërtetua në bazë të kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë e dt. 23.02.1988, deklarimeve të dëshmitarëve R. T. dhe M. H. si dhe provave tjera të besuara si në shkresat e lëndës. U vërtetua fakti gjithashtu se paditësit këtë paluajtshmëri e shfrytëzojnë në mënyrë që qetë e të lirë më shumë se 25 vite. Të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë lëndore paditësit e kanë fituar në bazë të parashkrimit fitues. Paluajtshmëria lëndore nga ana e paditësve është mbajtur me mirëbesim, ndërgjegjshmëri dhe ndershmëri konform nenit 28 par. 2 të LMBTH, si dhe konform nenit 40 pika 1 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore që ka të bëjë me fitimin e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues si mënyrë origjinare e fitimit të kësaj të drejte. Gjykatës i propozoi që kërkesë padinë ta aprovoi në tërësi si të themeltë duke u mbështetur në ligj.

- Shpenzimet procedurale nuk i kërkoi.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve në përgjigje në padi të dhënë me dt.15.03.2018, ka theksuar se e kontestoj në tërësi padinë dhe kërkesën e saj konsiderojmë se padia dhe kërkesa e saj është e paqartë, renditja e kërkesave edhe në këtë paqartësi është jo ligjore. Meqenëse barra argumentuese mbetet në palën paditëse, i padituri e rezervon të drejtën e kundër argumentimit sipas nevojës, andaj i propozojë Gjykatës që ta refuzoi padinë si të pabazuar.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve deklaron se ne parimisht dhe tani për tani mbesim si në përgjigje në padi, mirëpo nëse pala paditëse në prova do të argumentoj kërkesë padinë, atëherë edhe qëndrimi ynë mund të jetë ndryshe. Shton se nuk i kundërshton propozimet e palës paditëse.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve në fjalën e tij përfundimtare deklaron se i analizuar me vëmendje provat në këtë çështje juridike duke filluar nga padia, ekspertiza e ekspertëve përkatës si dhe provat me dëgjimin e dëshmitarëve. Konsideroi se deri diku ekziston arsyeja e bazueshmërisë së padisë, mirëpo për çështje të aprovimit të saj apo jo ja lë në vlerësim të lirë kësaj Gjykate. Sa i përket shpenzimeve në këtë procedurë meqenëse bëhet fjalë për pesë të paditur, ku vlera e kontestit është 5.000 €, andaj për çdo përfaqësim të paguhet shuma prej nga 405, 60 €, ashtu që për tri përfaqësime të paguhet shuma e gjithmbarshme.

- Shpenzimet procedurale i kërkoi sipas OAK-së, duke marrë parasysh gjendjen materiale të palës paditëse shumë e lartë cekur e zvogëloi ashtu që në tërësi detyrimi i pagesës duhet të jetë 1.000,00 €.

Gjykata gjatë procedimit të kësaj çështje të paditurve iu ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi, mirëpo siç shihet nga flet-dërgesa është konstatuar se të paditurit në këtë adresë janë të panjohur. Gjykata e ka detyruar të autorizuarin e paditësve që gjykatës t'ia sjellë adresën e saktë të paditurve në afat prej 3 ditëve, ndërsa i autorizuari i paditësit ka kërkuar nga gjykata që të paditurve të iu caktohet përfaqësuesi i përkohshëm, në bazë të nenit 79,3 nën paragrafi b) të LPK-së, pasi që palët gjenden në botën e jashtme. Gjykata me Aktvendim iu ka caktuar të paditurve, përfaqësuesin e përkohshëm E. B. avokat nga Gjakova. Po ashtu aktvendimi është publikuar në Gazetën e përditshme ditore "Z." me dt.09.12.2017 dhe në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës me dt.16.01.2018.

Gjykata pas vlerësimit të fakteve juridiko-relevante të kësaj çështje, çmuarjes së provave materiale, dhe në mbështetje të nenit 8 të ligjit për Procedurën Kontestimore nr.38/2008, vërtetoi se kërkesë-padia e paditësve është e bazuar dhe si e tillë u miratua.

Gjykata në procedurën e provave ka bërë administrimin e provave si; Kontratën mbi shitblerjen e paluajtshmërisë e lidhur me dt.23.02.1988 në mes të H.B. dhe Xh. K. Certifikata mbi të drejtat pronësore lëshuar nga DGJK e dt. 23.08.2016, e cila paluajtshmëri evidentohet në emër të H. B. Ekstrakti i lëshuar nga Zyra e gjendjes civile në fsh.B. K. Gjakovë, të dt.24.08.2016, në emër të L. K. Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e gjendjes civile në fsh. C. të dt.23.08.2016, në emër të Xh. K.t, Ekstrakti i gjendjes civile në Gjakovë të dt.23.08.2016, në emër të A. K. Certifikata e lindjes në gjuhën gjermane në emër të S. K., S. K. dhe S. K. dhe S.të lëshuar me dt. 26.08.2016, Transaksioni i konsumatorit në emër të ndjerit Xh. K. të lëshuar nga K., me dt.30.05.2018, Kartela financiare e tatimit në pronë në emër të ndjerit Xh. K. të dt.30.05.2018, ekspertiza e përpiluar nga ekspertët e DGJK B. M. dhe G. B. e dt.10 gusht 2018 dhe ekspertiza e ekspertit të ndërtimtarisë K. K. e përpiluar në gusht/2018, si dhe dëgjimin e dëshmitarëve R. T. nga fsh.B. Komuna e Gjakovës dhe M. H. nga Gjakova.

Nga provat e administruara u argumentua gjendja faktike si më poshtë:

Nga Kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë e lidhur me dt.23.02.1988 në mes të H.B. si shitës në një të anë dhe Xh. K. si blerës në anën tjetër, janë marrë vesh që shitësi të ia shes ndërsa blerësi të blejë prej tij shtëpinë familjare e cila gjendet në Gjakovë ish rr. “...” nr...., sipas fletë posedimit nr... KK C., ngastra kadastrale nr. ... në sipërfaqe të përgjithshme pre 0.05.03 ha, dhe se çmimi ka qenë 1.200.00.000 njëqind e njëzet milion dinarë. Në fund të kësaj kontrate është nënshkruar nga blerësi Xh. K. dhe shitësi H.B.dhe në prezencë të tre dëshmitarëve të cilët vetëm kanë nënshkruar.

Nga Certifikata mbi të drejtat pronësore lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në Gjakovë me dt.23.08.2016, lidhur me ngastrën kadastrale nr...., zona kadastrale J.Qytet, pronë private, vendi i quajtur C. P. në sipërfaqe prej 503 m2, me 1/1, evidentohet në emër të H. B.

Nga Ekstrakti i lëshuar nga Zyra e gjendjes civile në fsh.B. K. Gjakovë të dt.24.08.2016, konstatohet se L. K. data e lindjes ... në fsh.B. nga ia ti B. T. dhe e ëma Sh. T. Nga Certifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e gjendjes civile në fsh. C. të dt.23.08.2016 në emër të Xh. K.t, konstatohet se i njëjti data e lindjes ... në fsh. C. i njëjti ka qenë i martuar me L. K. dhe se i njëjti ka vdekur me dt.15.02.2011. Nga Ekstrakti i gjendjes civile në Gjakovë të dt.23.08.2016, në emër të A. K. konstatohet se i njëjti ka lindur me dt.27.12.1974 në Gjakovë nga i ati Xh. K. dhe e ëma L. K. - T. Nga Certifikata e lindjes të lëshuar nga Republika e Gjermanisë në gjuhën gjermane në emër të S. K., konstatohet se i njëjti data e lindjes ... në M., nga i ati Xh. K. dhe e ëma L. K. – T. Nga Certifikata e lindjes të lëshuar nga Republika e Gjermanisë në gjuhën gjermane në emër të S. K., konstatohet se i njëjti data e lindjes... në M., nga i ati Xh. K. dhe e ëma L. K. – T. Nga Certifikata e lindjes të lëshuar nga Republika e Gjermanisë në gjuhën gjermane në emër të S. K. konstatohet se i njëjti data e lindjes ..., në M, nga i ati Xh. K. dhe e ëma L. K. – T. Nga Certifikata e lindjes të lëshuar nga Republika e Gjermanisë në gjuhën gjermane në emër të S. K., konstatohet se i njëjti data e lindjes ... në M., nga i ati Xh. K. dhe e ëma L. K. – T. Në bazë të provave të lartcekura Gjykata vërtetoi faktin se si trashëgimtar të të ndjerit Xh. K. ish nga Gjakova, paraqiten paditësit e lartcekur.

Nga fatura e tatimit në pronë të dt.30.05.2018 në emër të ndjerit Xh. K. ish nga Gjakova Rr. “...” nr...., dhe Transaksioni i konsumatorit të lëshuar nga K. në emër të të ndjerit Xh. K. ish nga Gjakova Rr. “...” nr...., pala paditëse me këto prova ka dëshmuar se është posedim të paluajtshmërisë lëndore duke bërë pagimin e tatimit në pronë dhe pagesat për shfrytëzimin e energjisë elektrike.

Nga ekspertiza e përpiluar nga ekspertët e DGJK B. M. dhe G. B. e dt.10.08.2018 të dhënë në formë të shkruar kanë konstatuar se ngastra nr.... me kulturë jo pjellore në sipërfaqe 0.05.03 ha sipas evidencës kadastrale evidentohet në emër të H. B. Në mungesë të planit origjinal i cili është i vjedhur nga masat e dhunshme gjatë viteve 95-99 pjesa grafike të ngastrës nr.... nuk kemi mundësi ta paraqesim gjendjen kadastrale prandaj në ekspertizë kemi paraqitur gjendjen faktike në teren të ngastrës nr....Gjakovë J.Qytet.

Nga Ekspertiza e përpiluar nga eksperti i arkitekturës - ndërtimtarisë K. K., gusht/2018, i njëjti pas daljes në vend dhe marrjes së veprimeve tjera ka kontestuar se vlera e shtëpisë së banimit – objektit “A” e cila është ndërtuar në paluajtshmërinë lëndore është në vlerë prej 207.477.43 €, ndërsa vlera e objektit “B” është në vlerë prej 17.200.35 € ndërsa vlera e parcelës e cila është objekt lëndor është në vlerë prej 82.375.00 €.

Në shqyrtimin gjyqësor në cilësinë e ekspertit gjykata ka proceduar ekspertin e gjeodezisë G. B. i cili ka deklaruar se pas matjeve të bëra në teren në ekspertizë kemi paraqitur gjendjen faktike të ngastrës ... me kulturë jo pjellore në sipërfaqe prej 0.05.03 ha, e cila sipas evidencës kadastrale evidentohet në emër të B. H. sa i përket gjendjes faktike të parcelës i kemi dhënë dimensionet, po ashtu i kemi të vizatuara edhe dy objektet të cilat i kanë sipërfaqet në ekspertizë të shënuara, po sa i përket dimensionet e objekteve nëse është e nevojshme mundet me bërë me plotësim ekspertizën për të dy objektet, ku në ekspertizë është cekur se shtëpia ka sipërfaqe prej 195 m2, podrum – përdhes dhe nën kulm, ndërsa objekti tjetër ka sipërfaqe prej 159 m2 me kulturë përdhese. Si dhe oborri në sipërfaqen e përgjithshme prej 305 m2. Eksperti ka shtuar se sipas gjendjes kadastrale është në sipërfaqe prej 0.05.03 ha. Ndërsa sipas gjendjes faktike 0.06.59 ha, çka do të thotë se është më e madhe në krahasim me gjendjen kadastrale rreth 156 m2. Për shkak se nuk kem pas mundësi me qit gjendjen kadastrale pasi që janë marrë shënimet.

Nga procedimi i dëshmitarit R. T. nga fsh.B. Komuna e Gjakovës, në shqyrtimin gjyqësor i njëjti ka deklaruar se unë kam qenë prezentë kur është bërë pazari në vitin 1988 dhe marrëveshja për çmimin ka qenë 120 milion dinarë, prezentë ka qenë edhe vëllai i H. H. i cili me sa dijë unë kanë vdekur, prezentë ka qenë edhe M. H. dhe disa persona tjerë dhe pagesa është bërë në prezencën tonë, mbas një kohe të shkurtër është liruar shtëpia prej H. pasi që i njëjti kishte blerë një shtëpi tjetër, ku i ndjeri pastaj ka hyrë në shtëpi e cila ka qenë shtëpi e vjetër e cila pas luftës është rrënuar, ndërsa shtëpinë e re paditësit e kanë ndërtuar për afërsisht 6-7 vite, obligimet – pagesat i kanë kryer obligimet, mirëpo për neglizhencë nuk është bërë bartja e paluajtshmërisë, është përpiluar kontratë dhe unë kam qenë nënshkruar në cilësinë e dëshmitarit dhe se në kontratën e prezantuar nënshkrimi është i imi.

Nga procedimi i dëshmitarit M. H. nga Gjakova, në shqyrtimin gjyqësor i njëjti ka deklaruar se kur ka filluar pazari kam qenë iniciator mes dy palëve për pazarin e shtëpisë dhe që ata kanë ardhë në mirëkuptim me njëjti tjetrin për pazarin e shtëpisë në vlerë 120 milion dinarë dhe janë dhënë me kohë, mandej ka qenë biseda me e përkthyer shtëpinë, ai ka garantuar se shtëpia përkthehet menjëherë, por ka mbetur ditë pas ditë pasi që i njëjti ka qenë në botën e jashtme dhe se filloi keqësimi i gjendjes politike në Kosovë edhe mbete shtëpia pa u përkthye. Por bisedat kanë qenë si garantuese në dëshmitarë dhe se ka mbetur deri në ditën e sodit. Kontratën e kam përpiluar unë dhe po ashtu kam qenë ndërmjetësimin e dëshmitarit dhe siç shihet në kontratë kam qenë nënshkruar. Pas luftës me që paditësi ka jetuar në botën e jashtme ka ardhur dhe shtëpia e vjetër ka qenë e rrënuar dhe përafërsisht në vitin 2004 ka bërë ndërtimin e shtëpisë së re e cila tani është ekzistuese. I ndjeri H. i ka tre djem e dy vajza.

Gjykata pas vlerësimit dhe analizimit të provave veç e veç erdhe në përfundim se kërkesë-padia e paditësve është e bazuar dhe si e tillë u miratua duke u bazuar në provat e administruara u vërtetua se paditësit këtë paluajtshmëri e ka fituar në bazë të Institutit të mbajtjes me mirëbesim konform nenit 28 par.2 të Ligjit mbi bazat themelore të marrëdhënieve juridiko pronësore dhe në bazë të nenit 40 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore nr.03/L-154, mbi ngastrën kadastrale nr...., zona kadastrale J.Qytet, pronë private, vendi i quajtur C. P. në sipërfaqe prej 503 m2, në bazë të fitimit me parashkrim, pasi që paraardhësi i paditësve Xh. K. ish nga Gjakova ka qenë në posedim mbi 27 vite në këtë paluajtshmëri, kjo u vërtetua edhe nga dëshmia e dëshmitarëve R. T. nga fsh.B. Komuna e Gjakovës dhe M. H. nga Gjakova, të cilët dëshmuar se i ndjeri Xh. K. ish nga Gjakova si paraardhës i paditësve e ka blerë këtë paluajtshmërinë nga i ndjeri H.B. ish nga Gjakova si paraardhës i të paditurve po ashtu është dëshmuar se ka qenë në posedim të kësaj paluajtshmërie mbi 27 vite ku edhe ka bërë ndërtimin e shtëpisë e cila sipas ekspertit të ndërtimtarisë K. i njëjti ka kontestuar se vlera e shtëpisë së banimit – objektit “A” e cila është ndërtuar në paluajtshmërinë lëndore është në vlerë prej 207.477.43 €, ndërsa vlera e objektit “B”

është në vlerë prej 17.200.35 €, ndërsa vlera e parcelës e cila është objekt lëndor është në vlerë prej 82.375.00 €. Po ashtu Gjykata vendimin e vet lidhur me posedimin e paditësve e vërtetoi edhe me pagesën e tatimit në pronë, pagesën e energjisë elektrike të cilat evidentohen në emër të ndjerit Xh. K. ish nga Gjakova, po ashtu Gjykata vërtetoi faktin se i ndjeri Xh. K. ish nga Gjakova paraardhësi i paditësve me të ndjerin H.B.ish nga Gjakova paraardhësi i të paditurve kanë lidhur Kontratë mbi shitblerjen e paluajtshmërisë me dt.23.02.1988 në mes të “H.B. si shitës në njërën anë dhe Xh. K. si blerës në anën tjetër, janë marrë vesh që shitësi të ia shes ndërsa blerësi të blejë prej tij shtëpinë familjare e cila gjendet në Gjakovë ish rr. “...” nr....., sipas fletë posedimit nr.811 KK C., ngastra kadastrale nr. ... në sipërfaqe të përgjithshme pre 0.05.03 ha, dhe se çmimi ka qenë 1.200.00.000 njëqind e njëzet milion dinarë. Në fund të kësaj kontrate është nënshkruar nga blerësi Xh. K. dhe shitësi H.B.dhe në prezencë të tre dëshmitarëve të cilët vetëm kanë nënshkruar.”, mirëpo nuk është legalizuar pranë organeve gjegjëse andaj nuk është përmbushur ana ligjore për njohjen e të drejtës së pronësisë në bazë të shitblerjes, mirëpo i njëjti ka hyrë në posedim dhe ka bërë ndërtimin e shtëpisë, çka do të thotë se është krijuar mirëbesimi si kusht i parashkrimit fitues në bazë të posedimit. Andaj Gjykata duke u bazuar në provat e lartcekura kërkesë-padinë e paditësve e aprovoi si të bazuar dhe si të tillë e miratoi duke u bazuar në dispozitat e neneve 28 par.2 të Ligjit mbi bazat themelore të marrëdhënieve juridiko pronësore dhe në bazë të nenit 40 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore nr.03/L-154.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës u muarr konform nenit 450 të LPK-së.

Andaj për arsyet e lartë cekura kjo Gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**  
**C.nr.68/2017, të dt.11.01.2019**

**GJYKATËSI**  
**Drilon HARAÇIA**

**UDHËZIM JURIDIK;** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj Gjykate.